



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 394 Akti

Nr. 527 Vendimi
Tiranë, më 4.5.2022

V E N D I M

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------|----------|
| Roland Ilia | Kryesues |
| Etleda Çiftja | Relatore |
| Pamela Qirko | Anëtare |

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 4.5.2022, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Capo (Zere)**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit kalimtar.**

BAZA LIGJORE: **Neni G i Aneksit të Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “a”, e pikës 1, të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 25.2.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shkresën nr. *** datë 29.3.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për arsyet e heqjes dorë nga statusi i magjistratit nga subjekti i rivlerësimit Anila Capo (Zere), e cila ka kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Anila Capo (Zere), gjatë periudhës së procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Anila Capo (Zere), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më 16.12.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe, më tej, Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues, me vendimin e datës 13.1.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.
5. Trupi gjykues, me anë të postës elektronike¹, datë 13.1.2020, njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu, u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar më 16.12.2019 dhe iu kërkuua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.
6. Në mbledhjen e datës 14.2.2022, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi arriti në përfundimin se provat në lidhje me kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë,

¹E-mail, datë 13.1.2020, “Komisioni – Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

me vendimin e datës 14.2.2022, vendosi të mbyllë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Anila Capo (Zere) vetëm për kriterin e pasurisë, si dhe të njoftojë subjektin se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, sipas përcaktimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

7. Me anë të postës elektronike², në datën 14.2.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi vendimin e trupit gjykues për mbylljen e hetimit administrativ kryesisht dhe kalimin e barrës së provës për kriterin e pasurisë. Subjektit iu bënë me dije të drejtat që gëzon sipas ligjit për: (i) njohjen me dokumentet e dosjes dhe marrjen kopje të tyre menjëherë pas marrjes së njoftimit; (ii) të drejtën për të thirrur dëshmitar apo marrjen e çdo prove mbështetëse; (iii) të drejtën për të paraqitur shpjegime apo prova me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit, jo më vonë se data 28.2.2022. Bashkëlidhur këtij *e-mail*-i, subjekti të rivlerësimit iu dërguan: (i) rezultatet e hetimit kryesisht në versionin *word* dhe *pdf*; (ii) analiza financiare në *excel*; si dhe (iii) shpjegimet mbi analizën financiare.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoh dhe mori kopje të dokumentacionit përbërës të dosjes së hetimit kryesisht nga Komisioni.

9. Në datën 21.2.2022, me anë të postës elektronike³, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrje të afatit të paraqitjes së provave dhe shpjegimeve sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për barrën e provës kaluar me rezultatet e hetimit kryesisht të dërguara nga trupi gjykues në datën 14.2.2022. Në të njëjtin *e-mail* subjekti i rivlerësimit kërkoi përfshirjen në rezultatet e hetimit edhe të dy kriterëve të tjera të vlerësimit: kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

10. Komisioni, me anë të postës elektronike⁴, në datën 22.2.2022 njoftoi subjektin se mund t’i dërgonte shpjegimet dhe provat sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në përgjigje të barrës së provës deri në datën 7.3.2022, për provat që nuk kishte pasur mundësi t’i siguronte nga autoritetet shtetërore dhe, ndërkohë, për provat dhe shpjegimet që nuk kishte kërkuar shtyrje afati, Komisioni i kërkoi t’i dërgonte brenda datës 28.2.2022. Ndërkohë që, lidhur me kërkesën për përfshirjen në rezultatet e hetimit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni e informoi se nëse me anë të shpjegimeve dhe provave gjatë procesit në vazhdim subjekti arrin të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për kriterin e pasurisë, trupi gjykues, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, diskuton dhe vendos për të dy kriteret e tjera.

11. Në datën 28.2.2022, me anë të postës elektronike⁵ dhe shkresës së depozituar në Komision, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova në përgjigje të barrës së provës mbi kriterin e pasurisë, kaluar me anë të rezultateve të hetimit administrativ, për atë pjesë të barrës së provës për të cilin subjekti nuk kishte kërkuar shtyrje të afatit të paraqitjes së raporteve.

12. Ndërkohë që, Komisioni ishte në pritje të provave dhe shpjegimeve të barrës së provës për të cilat subjekti kërkoi kohë shtesë dhe shtyu afatin deri në datën 7.3.2022. Me anë të postës

²*E-mail*, datë 14.2.2022, ora 14:52, “Komisioni – Njoftim mbi mbylljen e hetimit kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

³*E-mail*, datë 21.2.2022, ora 13:37, “Kërkesë për shtyrje afati”.

⁴*E-mail*, datë 22.2.2022, ora 14:55, Re: “Kërkesë për shtyrje afati”.

⁵*E-mail*, datë 28.2.2022, ora 14:39, “Shpjegime në lidhje me raportin paraprak dhe pasqyra”.

elektronike⁶, në datën 4.3.2022 subjekti i rivlerësimit njoftoi se ka paraqitur kërkesë për dorëheqje të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe funksioni i gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke bashkëlidhur edhe kopje të kërkesës. Gjithashtu, Këshilli Lartë Gjyqësor ka dërguar me anë të postës elektronike kopjen e kërkesës së depozituar nga subjekti i rivlerësimit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2022, nga KLGJ-ja.

13. Më tej, në datën 30.3.2022, Komisioni administroi shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2022, të KLGJ-së, me anë të së cilës u njoftua se në mbledhjen e datës 25.3.2022 është marrë vendimi nr. ***, datë 25.3.2022, në të cilin është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Anila Capo (Zere), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së saj. Bashkëlidhur kësaj shkrese KLGJ-ja dërgoi kopjen e vendimit nr. ***, datë 25.3.2022.

14. Bazuar në faktet se: (i) KLGJ-ja, me vendimin nr. ***, datë 25.3.2022, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Anila Capo (Zere), gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes nga ky status; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 25.3.2022, të KLGJ-së, Komisioni me anë të postës elektronike i kërkoi subjektit të rivlerësimit konfirmimin e vullnetit të tij të pavesuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, duke e njoftuar edhe mbi pasojat e kësaj dorëheqjeje për efekt të procesit të rivlerësimit.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike që konfirmimin mund ta jepte duke u dëgjuar në seancë dëgjimore, si një e drejtë e saj, sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2014, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ose nëse nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore për këtë konfirmim me anë të postës elektronike, në adresën e e-mail-it, që komunikon për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti mund të konfirmojë se nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore, si dhe konfirmon vullnetin e saj të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e dhënë pranë KLGJ-së.

16. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, konfirmoi vullnetin e saj se nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore dhe konfirmoi vullnetin e saj të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e parashtruar dhe të miratuar nga KLGJ-ja.

17. Komisioni konstatoi se me vendimin nr. ***, datë 25.3.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Anila Capo (Zere), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁷

18. Kolegji i Posaçëm Apelimit, në lidhje me praktikat e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në faza të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen

⁶E-mail, datë 4.3.2022, ora 09:47, “Kërkesë”.

⁷Referojuni vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, paragrafëve 96 dhe 97, të Kolegjit.

e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

19. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

20. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, në datën 30.3.2022 është depozituar njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor – *për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes*.

21. KLGj-ja, bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 25.3.2022, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. Anila Capo (Zere), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë vendim, krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit Anila Capo (Zere).

22. Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të postës elektronike ka dërguar aktet e depozituara nga znj. Anila Capo (Zere) për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, respektivisht kërkesën e datës 4.3.2022.

23. Më tej, me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2022, KLGj-ja ka informuar Komisionin se me shkresën *** prot., datë 21.4.2022, i është kërkuar informacion (në rrugë elektronike dhe me postë) Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nëse znj. Anila Capo (Zere) ka paraqitur ose jo ankim në këtë gjykatë ndaj vendimit nr. ***, datë 25.3.2022, të KLGJ-së. Përmes komunikimit elektronik të datës 21.4.2022, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vënë në dijeni KLGJ-në se deri në datën 20.4.2022 nuk është paraqitur ankim ndaj këtij vendimit

c. Ftesa për seancë dëgjimore dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

24. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të drejtës që gëzon subjekti i rivlerësimit për t'u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, datë 22.9.2020, Komisioni, me anë të postës elektronike⁸, njoftoi subjektin se dorëheqja gjatë procesit të rivlerësimit bazohet në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “(i) subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet; (ii) subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare” dhe, për këtë arsye, i kërkoi subjektit të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin mbi dorëheqjen nga statusi i magjistratit në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.

⁸E-mail, datë 26.4.2022, ora 11:47, “Komisioni – konfirmim i vullnetit të dorëheqjes nga procesi juaj i rivlerësimit”.

25. Subjekti i rivlerësimit Anila Capo (Zere), me anë të postës elektronike⁹, konfirmoi vullnetin e saj se nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore dhe konfirmoi sërish vullnetin e saj të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e saj të parashtruar dhe të miratuar nga KLGJ-ja.

26. Referuar akteve sa më sipër, Komisioni konfirmon vullnetin e pavesuar të subjektit për dorëheqjen e paraqitur pranë KLGJ-së, si dhe konfirmimin se nuk do të dëgjohet në seancë dëgjimore publike, pasi znj. Anila Capo (Zere) ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pasi ky këshill ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili ka marrë formë të prerë.

d. Ligji i zbatueshëm për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit

27. Në germën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

28. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

29. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

30. Vendimi nr. ***, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

e. Arsyetimi ligjor i fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

31. Bazuar në rrethanat e sipërcituara, në bazën ligjore përkatëse, në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në konfirmimin e vullnetit të lirë dhe të pavesuar për dorëheqjen nga

⁹E-mail, datë 26.4.2022, ora 21:00, Re: “Komisioni – konfirmim i vullnetit të dorëheqjes nga procesi juaj i rivlerësimit”.

statusi i magjistratit, në deklarimin e subjektit se nuk dëshiron të dëgjohet në seancë dëgjimore, referuar fakteve të cituara më lart, si dhe

Duke qenë se:

- i. subjekti i rivlerësimit Anila Capo (Zere) ka kërkuar deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes nga statusi;
- ii. Këshilli i Lartë Gjyqësor e ka miratuar kërkesën e subjektit dhe ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit Anila Capo (Zere), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- iii. subjekti i rivlerësimit nuk e ka ankimuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, vendimin nr. ***, datë 25.4.2022, të KLGJ-së;
- iv. Komisioni kërkoj konfirmimin e shprehjes së vullnetit të subjektit, në lidhje me dorëheqjen nga statusi i magjistratit, si dhe i bëri me dije pasojat që vijnë nga kjo dorëheqje sipas parashikimeve të nenit G të Aneksit të Kushtetutës; si dhe
- v. subjekti i rivlerësimit konfirmoi me *e-mail* se dorëheqja nga statusi është me vullnet të lirë dhe të pavesuar dhe nuk dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore publike.

32. Trupi gjykues vlerëson se vullneti i plotë dhe i pavesuar i subjektit të rivlerësimit për dorëheqje konfirmohet nga deklaratimet e saj më lart.

33. Trupi Gjykues i Komisionit çmon se referuar fakteve të evidentuara me lart, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Anila Capo (Zere), duhet të ndërpritet sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

34. Për sa më sipër, në referim të germës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vlerëson se procedura administrative për këtë subjekt mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimi të seancës dëgjimore.

35. Komisioni çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin Anila Capo (Zere) duhet ndërprerë sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare bazuar në pikën 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në germën “b”, të nenit 89, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 dhe në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Anila Capo (Zere), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Anila Capo (Zere), si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 4.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj